



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0757

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE N.T.SH. “BEDI COM”, kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj” me numër të prokurimit 617-24-4105-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SHTIME”, më 01/10/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e N.T.SH. “BEDI COM” me nr. 2024/0757, e datës 23/08/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj”, me numër të prokurimit 617-24-4105-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SHTIME”.
2. Vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj” lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 06.06.2024, “KOMUNA SHTIME” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj” me numër të prokurimit 617-24-4105-1-1-1. Ndërsa me datë 12.08.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e

Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 168,468.10 €.

Me 13.08.2024, OE N.T.SH. “BEDI COM” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 14.08.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23/08/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.T.SH. “BEDI COM” me nr. 2024/0757 lidhur me aktivitetin “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj” me numër të prokurimit 617-24-4105-1-1-1

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim: Refuzohet, si e pa bazë kërkesa për rishqyrtim nga OE, N.T.SH. ” BEDI COM ”, Prishtina, 10000, Prishtinë, lidhur me projektin: “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj” AK , “Komuna e Shtimes” komisioni vlerësues, ka bërë vlerësimin e ofertave në bazë të kriterëve të vendosura në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit. Për komisionin vlerësimi dhe nëse AK, dëshmia e ofruar për kontratat me qera për makineri, nuk është në përputhje me kërkesën e AK-së . Dëshmitë. Ju në ofertën e juaj nuk keni dëshmuar librezën qarkullimit, kontrata me qera, po nuk ju përputhen datat e nënshkrimit së marrëveshjes, ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Edhe pasë informacionit sqarues me 05.08.2024, ju nuk i keni dëshmuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.SH. “BEDI COM” janë parashtruar si në vijim: Kronologjia e aktivitetit të prokurimit “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj” Vlerësimi i ofertave nuk është bërë sipas dispozitave të LPP dhe kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit. Për më tepër ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i dokumenteve të dorëzuara nga OE N.T.SH. “BEDI COM” nuk është bërë në mënyrë profesionale, dokumentet nuk janë trajtuar mjaftueshme dhe për pasojë oferta jonë është eliminuar pa të drejtë si dhe është anuluar aktiviteti i prokurimit. Bazuar në arsyetimin e dhënë në Vendimin e AK të datës 12.08.2024, OE N.T.SH. “BEDI COM”, citim “III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 6.Lista e mjeteve te punës. Kamion me kran për bartjen e druve min. 10 ton. 1 cope, Kamion te rend min. 10 ton .2 cope Dëshmia 6. Lista e pajisjeve - mjeteve te punës. OE duhet ti këtë te vetat apo te kontraktuara, (apo me qira). Te dëshmohet se pajisjet motorike janë te regjistruara dhe janë valide-Kopja e librezave. Nëse pajisjet janë me qira duhet kontrata e marrjes me qira te pajisjeve për projektin 4/6 ne fjale e cila duhet te jete e vulosur dhe e nënshkruar nga te dy palët për kohen sa zgjate projekti. 1. Marrëveshjet qe ju keni ngarkuar pas

kërkesën për informacione shtese me date 01.08.2024 ,nuk plotëson kriteret. Ju i keni ngarkuar 3 marrëveshje për kamiona, ku ne ato marrëveshje figurën data 01.04.2024, 01.05.2024 dhe 01.06.2024 me emër te projektit ne fjale ku data te marrëveshjeve nuk përputhen me datën e publikimit te njoftimit për kontrate pasi qe njoftimi për kontrate është publikuar me date 06.06.2024 Për ne si AK kërkesa nr. 6 nuk është plotësuar ashtu siç është kërkuar ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit”.

Konstatimi i Komisionit për Vlerësimi dhe i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit nuk është i saktë dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, për arsyet në vijim:

Së pari: N.TSH. “BEDI COM” ka ofruar kontrata për tre kamionët në kohëzgjatje prej 36 muajve, ndërsa kohëzgjatja e kontratës për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj është 24 muaj”. Pra kontratat për kamionët që ne i kemi ofruar e mbulojnë kohëzgjatjen e kontratës.

Së dyti: Kontratat janë të lidhura me OE privat dhe N.T.SH. “BEDI COM” për shfrytëzimin e kamionëve i ka bërë këto marrëveshje para publikimit të aktivitetit të prokurimit nga Komuna e Shtimes dhe kjo për arsye se është dashtë më herët të sigurohen marrëveshjet për sigurimin e pajisjeve – kamionëve për nevojat e N.T.Sh. “Bedi Com”. Pra dhënësit e kamionëve me qira i kanë kushtet e tyre për dhënie me qira të kamionëve dhe nuk ju intereson nëse marrësi me qira i kamionëve pritet të realizoj projekte apo jo. Pra N.T.SH “BEDI COM” ka hyrë në këto marrëveshje për marrjen me qira të këtyre tre kamionëve para publikimit të aktivitetit të prokurimit “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj” nga Komuna e Shtimes dhe ka paguar qira sipas marrëveshjes.

Së treti: kur aktiviteti i prokurimit “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj” është shpallur nga Komuna e Shtimes dhe N.T.SH. “BEDI COM” i janë kërkuar kontrata për kamionët në emër të projektit – aktivitetit të prokurimit “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj”, në marrëveshje me dhënësit me qira të kamionëve e kemi plotësuar marrëveshjen paraprake vetëm për emër të aktivitetit të prokurimit “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj”.

Së katërti: N.T.SH. “BEDI COM” i kërkon Komisionit të Vlerësimit dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit që t’i ekzaminojnë edhe njëherë marrëveshjet për qira për kamionët, dhe ta rishqyrtojnë edhe njëherë vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj”. Përveç kësaj, N.T.SH. “BEDI COM” i sygjeron Komisionit për Vlerësim dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit që për ta vërtetuar validitetin e kontratave për të tre kamionët t’i kontakton qiradhënësit e tyre, në kontaktet në vijim: 1. Për kamionin e tipit MAN, me targa 04-157-JK, pronari Fazli Beqiraj, në emali: nptburimi@live.com dhe numër të tel 044 149 548; 2. Për kamionin e tipit MERCEDES BENZ, me targa 01-143-ZO, pronari Agim Aliu, email: integral_shpk@hotmail.com dhe numer te tel 044 505 800; dh 3. Për kamionin e tipit VOLVO, me targa 01-161-UK, pronar Mustaf Sekiraqa, email: sekiraqa69@hotmail.com dhe numër te tel 044 425 793. 5/6 Për arsye se kontratat për shfrytëzimin e kamionëve të njëjtë nuk lejohet ligjërisht të bëhen dy herë, pra nuk lejohet të bëhen dy kontrata për të njëjtin kamion dhe për të njëjtën periudhë kohore, Drejtori i N.T.SH. “Bedi Com” me pëlqimin të palëve tjera kontraktuese të njëjtat kontrata i ka plotësuar vetëm më titullin e aktivitetit të prokurimit siç ka kërkuar Komuna e Shtimes. Komisioni i Vlerësimit nuk ka kërkuar parë sqarime për këtë çështje dhe padrejtësisht e ka eliminuar OE

N.T.SH. "BEDI COM" si dhe e ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Bazuar ne nenin 38 Sqarimi i Tenderëve, paragrafi 38.1, në të cilin thuhet "Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj" për të siguruar prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen reale. Po ashtu në kërkesën për rishqyrtim, ne i kemi dhënë këto sqarime dhe informatat e palëve kontraktuese, në mënyrë që AK të marr edhe informata nga palët kontraktuesve lidhur më këto kontrata, mirëpo Komisioni i Vlerësimit dhe ZPP nuk i kanë trajtuar ato dhe kërkesa për rishqyrtim na është refuzuar.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56 dhe 59 te LPP-së. Prandaj, duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë që të nxjerrët: VENDIM të aprovohet, si e bazuar ankesa e OE N.T.SH. "BEDI COM" te anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 26/08/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0757/24, ndërsa me datë 05/09/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0757 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK është pajtuar me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk ka ofruar përgjigje rreth raportit te ekspertizës.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.T.SH. "BEDI COM" ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/0757 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Pretendimet të cilat janë ngritur nga operatori ankues janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti ka dhënë mendimin e tij si më poshtë:

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: "Vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me dispozitat e LPP-së. Ne jemi eliminuar me arsyetimin se nuk plotësojmë kriteret për kapacitetin teknik dhe

professional ku është kërkuar që të dorëzohet lista e mjeteve të punës. Kamion me kran për bartjen e druve min 10 ton. 1 cope dhe kamion te rend min. 10 ton. 2 copë. Ne kemi ofruar kontrata për tre kamion në kohëzgjatje prej 36 muajve, ndërsa kohëzgjatja e kontratës për aktivitetin e prokurimit është 24 muaj. Pra kontratat për kamion që ne i kemi ofruar e mbulojnë kohëzgjatjen e kontratës. Marrëveshjet janë lidhur para publikimit të aktivitetit për arsye të sigurimit të pajisjeve për nevojat tona dhe kemi paguar qera sipas marrëveshjes. Kur është shpallur aktiviteti nga komuna është kërkuar kontrata për kamionët në emër të projektit-aktivitetit të prokurimit, dhe është plotësuar marrëveshja paraprake. Kërkojmë që për marrëveshje të kontaktohen edhe personat përgjegjës për qeradhënie. Përderisa ligjërisht nuk lejohen të bëhen dy kontrata për të njëjtin kamion dhe për të njëjtën periudhë kohore, drejtori jonë të njëjtat kontrata i ka plotësuar vetëm me titullin e aktivitetit të prokurimit sipas kërkesave. AK nuk ka kërkuar fare sqarime dhe na ka eliminuar padrejtësisht.”

Eksperti shqyrtues sqaron se një nga kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional në dosjen e tenderit ka qenë që operatorët ekonomik duhet të ofrojnë listën e mjeteve të punës, një kamion me kran për bartjen e druve min. 10 ton dhe dy kamion të rëndë min. 10 ton. Si dëshmi për përmbushjen e kësaj kërkesë është kërkuar lista e pajisjeve, kopjet e librezave apo në rastin e marrjes me qera janë kërkuar kontratat e marrjes me qera të pajisjeve për projektin në fjalë e cila duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga të dy palët për kohën sa zgjatë projekti. Sipas kësaj kërkesë, OE ankues në ofertën e tij për të gjitha kërkesat e dosjes në kapacitetin teknik dhe profesional, përfshirë edhe pajisjet ka bashkangjitur vetëm listat por jo edhe dëshmitë e kërkuara.

Në bazë të nenit 72 të LPP-së, me datën 05/08/2024, AK përmes një kërkesë për sqarim ka kërkuar nga OE ankues që të dorëzoj librezat valide të mjeteve që janë cekur në listë. Përmes sqarimeve shtesë OE ankues me datën 06/08/2024, ka dorëzuar marrëveshjet për marrjen me qera për tre kamionët. Marrëveshjet e dorëzuara për marrje me qera të pajisjeve përmbajnë emrin dhe numrin e aktivitetit të prokurimit për të cilin janë të lidhura këto marrëveshje, ndërsa datat e nënshkrimit në këto marrëveshje janë datat 01/04/2024, 01/05/2024 dhe 01/06/2024. Eksperti pasqyron se njoftimi paraprak për emrin dhe numrin e aktivitetit të prokurimit është bërë me datën 25/04/2024 ndërsa njoftimi për kontratë ku janë përfshirë edhe kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional përmes të cilit caktohen kriteret të cilat duhet të përmbushen është bërë me datën 06/06/2024. Siç mund të shihet, marrëveshjet të cilat nuk kanë qenë fare pjesë e ofertës por janë sjellë me sqarime shtesë, datat e tyre janë data më të hershme se sa njoftimi për kontratë dhe madje njëra prej tyre ka datë edhe më të hershme se sa njoftimi paraprak. Sipas nenit 72 të LPP-së, përmes sqarimeve shtesë mund të kërkohen vetëm dokumente të cilat duken të jenë të paqarta apo të cilat mungojnë mirëpo të njëjtat duhet të vërtetohen në mënyrë objektive se kanë ekzistuar edhe para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Sipas mendimi të ekspertit, lidhja e marrëveshjeve të cilat nuk janë fare pjesë e ofertës, në datat në të cilat nuk janë ditur fare as emri apo numri i aktivitetit të prokurimit dhe gjithashtu nuk kanë qenë të ditura as kërkesat e FDT-së, e bënë të vështirë të vërtetohet ekzistimi i këtyre dokumenteve sipas LPP-së dhe vlerësojmë që këto marrëveshje nuk janë në përputhje me nenin 72 të LPP-së por mundësojnë plotësim apo pasurim të ofertës fillestare.

Sa i përket sqarimit të OE ankues, se këto dokumente kanë ekzistuar pa emrin apo numrin e prokurimit por që pasi ligji nuk lejon që të bëhen dy kontrata për pajisje dhe periudhë të njëjtë të marrjes me qera, në marrëveshje është shtuar vetëm ky detaj, sipas ekspertit edhe ky arsyetim nuk qëndron sepse sipas marrëveshjeve shihet se kamionët janë sipas kërkesave të FDT-së e cila është publikuar në datën e lartcekur dhe është pas lidhjes së këtyre marrëveshjeve. Andaj, konsiderojmë që këto kontrata nuk janë në përputhje me ligjin për prokurimin publik sepse nuk

mund të vërtetohen në mënyrë objektive se kanë ekzistuar edhe para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Nga kjo çfarë sqaruar më lartë, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nuk është i bazuar.

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.SH. "BEDI COM" Argumentimi në raportin e ekspertës shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës shqyrtuese mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertës shqyrtuese.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP-në si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertës shqyrtuese, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar.

Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E SHTIME” të datës 12.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimes, Kontratë Kornizë 24 muaj” me nr. të prokurimit: 617-24-4105-1-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - KOMUNA SHTIME
- OE - N.T.SH. " BEDI COM "
- Arkivës së OSHP-së: